

AKT-THEMELIMI
I
SHOQERISE TREGTARE “Debussy Fine Art” SH.P.K.

Ne baze te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe ne zbatim me ligjin nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ligjit nr 129/2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin 9901 date 14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare " te ndryshuar , sot **ne daten 05 /0 2/2024** behet themelimi i shoqerise **“Debussy Fine Art” SH.P.K** me seli ne **Tirane, Njesia bashkiake nr .5, rruga Nikolla Tupe, zk.8270, pasuria nr.3/110+1-N2**. Nga ortaket e kesaj Shoqerie

1. Alexandre Charles Nicolas Debussy, babai Thierry, i pajisur me nr personal H80920225B

VENDOSIN

Te krijojne nje Shoqeri Tregtare te emertuar **“Debussy Fine Art” SH.P.K** me kushtet e meposhtme:

NENI I

Themeluesi ne cilesine e ortakut krijojn shoqerine tregtare **“Debussy Fine Art” SH.P.K** me statusin juridik te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ne kuptimin e ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, ligjit 129/2014, me mjetet e veta financiare duke paguar kontributin ne para.

NENI 2

Shoqeria gezon statusin e personit juridik dhe veprimtaria e saj do te rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi, nga ky Akt-Themelimi dhe statutin e bashkelidhur.

NENI 3

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj me emertimin **“Debussy Fine Art” SH.P.K** emer ky qe do te shenohet ne te gjitha dokumentat, letrat, faturat etj.
Ajo ka vulen e saj ne te cilen eshte shkruar **“Debussy Fine Art”, SH.P.K**

NENI 4

Shoqeria e ka seline e saj ne:

Tirane, njesia bashkiake nr 5, rruga Nikolla Tupe, zk.8270, pasuria nr.3/110+1-N2.

Ajo mund te hape perfaqesi, dege ose filiale edhe ne qytete te tjera te Shqiperise.

NENI 5

Afati i veprimtarise se Shoqerise do te jete i pakufizuar, me perjashtim te rastit kur ortaket vendosin prishjen e saj.

NENI 6

Qellimi social/aktiviteti I shoqerise ne Shqiperi dhe ne mbare boten eshte:

- **Tregtimi (blerja dhe shitja) e punimeve te artit dhe antikave, duke vepruar si ndermjetes ne tregtimin e veprave te artit dhe antikave, duke ofruar sherbime brokerimi te arteve te bukura duke futur dhe ofruar biznes per transaksione ne vepra arti dhe antike. Ofrimi I sherbimeve me qira te arteve te bukura. Organizimi I ekspozitave te artit. Ofrimi i konsulences se artit. Agjent I artisteve (perfqasimi, promovimi dhe shitja e veprave te artistit). Botimi I veprave te artistit dhe librave te artit. Import-eksport. Dhe cdo aktiviteti tjetër te nevojshem lidhur me objektin e veprimtarise ne perputhje me legjislacionit Shqipetar.**

NENI 7

Me vendimin e themeluesit te saj, shoqeria mund te ndryshoje emrin, seline, formen juridike dhe objektin e veprimtarise, mbas berjes se ndryshimeve perkatese ne statut dhe ne kete akt themelimi.

NENI 8

Kapitali themeltar i shoqerise perfaqeson kontributet ne para dhe eshte **1.000.000** (njeqindmije) leke shqiptare.

Perbehet nga 1-kuote

Alexandre Charles Nicolas Debussy zoteron 1-kuote me vlere 1.000.000 leke, 100% te kapitalit themeltar

NENI 9

Shoqeria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitime. Ajo eshte pergjegjese per detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe personave te tjere.

NENI 10

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj administruese, ekonomike, financiare ne perputhje me legjislacionin perkates ne fuqi dhe dispozitat e statutit bashkelidhur.

Shoqeria do te drejtohet nga organet drejtuese qe perbehen nga asambleja e ortakeve dhe administratori. Themeluesit me vendim te veçante do te emerojne dhe nje ekspert kontabel. Shoqeria do te mbaje llogarite ne perputhje me ligjin, " Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare", si dhe do te krijojte fondin rezerve.

Fitimi neto qe do te rezultoje ne fund te cdo viti financiar pas zbritjes se fondit rezerve dhe humbjeve te mbajtura nga vitet e meparshme do ti kaloje ortakeve.

NENI 11

Percaktimi i struktures organizative te shoqerise, numri i punonjesve dhe emerimet e shkarkimet ne organet e saj behen me vendim te asamblese se ortakeve.

Administrator i Shoqerise emerohet **Z.Alexandre Charles Nicolas Debussy** lindur ne France e banues ne France i pajisur me karte identiteti me numer personal **H80920225B**.

Maredheniet e punes do te bazohen ne kontratat e punes te lidhura mbi bazen e legjislacionit ne fuqi.

NENI 12

Rregullat per drejtimin, organizimin dhe prishjen e shoqerise jane percaktuar ne statutin qe i bashkelidhet ketij Akt-Themelimi.

THEMELUESIT E SHOQERISE TREGTARE

Alexandre Charles Nicolas Debussy